

Plani me afate kohore për përgatitjen e strategjisë fiskale

Korniza kohore	Aktivitetet
deri në datë 5 mars	Sektori i Buxheteve dhe Fondeve dorëzon shkresë/letër qarkore tek sektorët në kuadër të Ministrisë së Financave dhe institucioneve të tjera për marrjen e të dhënave për përgatitjen e strategjisë fiskale për 5 vitet e ardhshme.
deri në datë 11 mars	Ministria e Financave dorëzon shkresë/letër qarkore te shfrytëzuesit buxhetorë për 5 vitet e ardhshme për strategjinë fiskale me udhëzime për përgatitjen e strategjisë fiskale
11 mars - 20 mars	Shfrytëzuesit buxhetorë të Buxhetit të shtetit përgatisin projeksione fiskale bazuar në legjislacionin ekzistues dhe detyrimet ekzistuese (skenari bazë) dhe propozim për projekte të reja dhe detyrime të reja financiare (nisma të reja)
20 mars -1 prill	Ministria e Financave analizon të dhënat e marra, harton skenar bazë dhe nisma të reja, si bazë për përgatitjen e Strategjie fiskale për 5 vjet.
1 prill - 11 prill	Ministria e Financave ia dorëzon për shqyrtim Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut skenarin bazë, nismat e reja dhe hapësirën fiskale për nismat e reja.
11 prill - 15 prill	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton skenarin bazë dhe nismat e reja financiare
15 prill - 25 prill	Ministria e Financave analizon të dhënat e marra nga Qeveria për skenarin bazë dhe nismat e reja, si dhe përgatit versionin përfundimtar të Strategjisë së propozuar fiskale për 5 vjet.
25 prill - 30 prill	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton Strategjinë fiskale
më së voni deri në datë 30 prill	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ia dorëzon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit Fiskal Strategjinë e miratuar fiskale.
më së voni deri në datë 30 prill	Ministria e Financave publikon në faqen e saj strategjinë fiskale
më së voni deri në datë 20 qershor të vitit fiskal rrjedhës	Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shqyrton strategjinë fiskale